

Ekskluzive

Ekskluzive | Policia zbulon arsenal armësh në një dasmë në Klinë – organizatori dorëzon kallashnikov, dy pistoleta dhe municion



Sinjali.com

02 Gusht 2026 12:26



Një aheng familjar në fshatin Rudicë të Klinës përfundoi me sekuestrimin e një arsenali armësh, pasi Policia ndërhyri pas raportimeve për të shtëna me armë zjarri.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Malinor Mehmetaj rreth 42 vjeçar**.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur pasditen e 1 gushtit, rreth orës 15:50, kur Stacioni Policor në Klinë u njoftua për të shtëna me armë gjatë një dasme në fshatin Rudicë.

Njësitë patrulluese dhe hetuesit kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, ku fillimisht organizatori i ahengut kishte mohuar se ishte përdorur armë zjarri.

Megjithatë, pas gjetjes së gëzhojave në vendin e ngjarjes dhe sigurimit të urdhrit për kontroll, i dyshuari ka ndryshuar qëndrim dhe ka bashkëpunuar me Policinë, duke dorëzuar vullnetarisht:

- një pushkë automatike AK-47 me karikator, kalibër 7.62×39 mm;
- një pistoletë Blow TR 92 (me gaz), kalibër 9 mm, me karikator;
- municion 9 mm për armën me gaz;
- një pistoletë TT (M-57) me karikator, kalibër 7.62×25 mm.

Të gjitha armët dhe municioni janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale, ndërsa Malinor Mehmetaj është shoqëruar në Stacionin Policor për intervistim.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim i armës”, ndërsa pas intervistimit ai është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera